

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, sipas gjyqtarit, Halil Zahiri, me s. Shefinaze Sahiti, në çështjen juridiko-civile të paditësit, F. Sh nga f. P, K e Gj, ndaj të paditurve, S.S Zh.Sdhe S1. S, nga f. P, Komuna e tani në adresë të panjohur, në Serbi, përkohësisht të përfaqësuar prej av...., nga Gj, për vërtetimin e të drejtës së pronsisë, në seancën kryesore dhe publike të mbajtur më dt.06.05.2017 bie këtë

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar, padia-kërkespadia e F. Sh nga f. P, , ndaj të paditurve, , nga f. P, Komuna e Gj, tani në adresë të panjohur në Serbi dhe **VËRTETOHET** se paditësi, në bazë të veprimit juridik, kontratës verbale për shitblerjen e pasurisë së paluajtëshme është pronar i ngas.kad.nr....., me kulturë parcel-pronë private, në sipërfaqe prej ...ha, e cila gjendet në v.q. „Kisela Voda,, në f. P, e regjistruar në bashkpronësi për nga 1/2 e pjesës ideale, në emër të Zh. Sd he S.S , nga f. P, sipas Çertifikatës sipas lëndës nr., e lëshuar më dt., nga DGJKP, në dhe ngas.kad.nr., në sipërfaqe prej 0.47,90 ha, me kulturë parcel-pronë private, në sipërfaqe prej gjithësejt 0.18,84 ha, e cila gjendet në v.q. ,.../ në f., e regjistruar në bashkpronësi për nga 1/2 e pjesës ideale, në emër të Zh.S dhe S. S, nga f. P sipas Çertifikatës sipas lëndës nr...., e lëshuar më dt. 14.02.2017, nga DGJKP, në Gjilan.

II. DETYROHEN, të paditurit ia njohin dhe pranojnë paditësit të drejtën e pronësisë për pasurinë e paluajtëshme, në bazë të veprimit juridik, kontratës verbale mbi shitblerjen e pasurisë së paluajtëshme dhe **REKOMANDOHET**, DGJKP, në Gjilan ta regjistroi, paditësin Feim Shala, si pronar juridik për pasurinë e paluajtëshme të cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, këtë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me vërejtje të përmbartimit të detyruar.

III. Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, gjykata vendosi, sejcila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi, F.Sh, më parë blerësi, nga f. P, sipas padisë së ushtruar më dt.05.01.2015, kësaj gjykate i ka konfirmuar, në bazë të veprimit juridik, Kontratës verbale për shitblerjen e pasurisë së paluajtëshme në vitin 2010, prej shitësit familjar me të paditurit, , tani në adresë të panjohur, në serbi, e kishte blerë pasurinë Kontestuese, të cekur si në padi, për çmimin kontraktues, në lartësi 23.500,00 €. Paditësi pasi ia ka paguar çmimin kontraktues të paditurve, ata ia kishin dorëzuar blerësit F. Sh pasurinë e paluajtëshme në shfrytëzim dhe pronësi faktike, të papenguar, nga të paditurit, familja e tyre apo megjenikët, të cilën pasuri paditësi e ka punuar mbi 15 vite.

Pasi në mes palëve kontraktuese ishin përmbushur detyrimet kontraktuese, tani paditësi pasurinë kontestuese e ka në posedim dhe shfrytëzim si pronar faktik, e punon mbi 15 vite dhe e ka mbjellur me rendimente bujqësore.

1. Paditësi, F.Sh nga f. P. në seancën kryesore të mbajtur më dt.06.05.2017, dhe seancat tjera, deklaroi se në tërësi qëndroi pran padisë-kërkespadi së dhe padisë së përmirësuar, i propozoi gjyqtarit të çështjes, të dalin me ekspert gjeodet në vendin e ngjarjes me palët ndërgjyqëse për ta identifikuar pasurinë kontestuese, të dëgjohet eksperti gjeodet, të administrohen të gjitha provat nga lënda dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata ta aprovoi në tërësi kërkespadi në e paditësit si të bazuar.

2. Përfaqësuesi i përkohëshëm av...., në emër të paditurve, , tani në adresë të panjohur, deklaroi se qëndroi pran përgjigjes në padi të ushtruar kësaj gjykate dhe për momentin e kontestoi kërkespadi në e paditësit, në mungesë të provave, pajtohem me propozimin e palës paditëse, se gjyqtari i çështjes të dalin me ekspert gjeodet në vendin e ngjarjes për të shiquar gjendjen faktike, të dëgjohen eksperti gjeodet dhe pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike e rezervoi të drejtën të deklarohe lidhur me zgjidhjen e çështjes kontestuese.

Në seancën kryesore të mbajtur më dt. 27.03.2017, gjykata i ka dëgjuar, palët ndërgjyqëse dhe ekspertin gjeodet si vijoi:

3. Eksperti gjeodet I.J, nga Gj, deklaroi, qëndroi në tërësi pran konstatimit me skicë të hartuar më dt.19.04.2017, nga vendi i ngjarjes, jam i gatshëm të përgjigjem në pyetjet e gjyqtarit dhe palëve ndërgjyqëse.

Në pyetjen e gjyqtarit, eksperti deklaroi se gjendja faktikenë në teren përputhet plotësisht me gjendjen juridike nga Çertifikata e pronës dhe Elaboratin kadastral, ndërsa pasurit konterstuese punohen nga paditësi dhe janë të mjellura me grur dhe bari për bagëti. Paditësi nuk ka pyetje dhe vërejtje. Përfaqësuesi i përkohëshëm pyet, a ka ndonjë rrugë në pasurinë kontestuese. Eksperti përgjigjet nuk ka kurrfar rrugen në parcelat kontestuese kurse ato kanë dalje në pjesen përendimore, në rrugen e asfaltuar.

Palët ndërgjyqëse pajtohen me konstatimin dhe skicën e hartuar nga vendi i ngjarjes, nuk kanë pyetje dhe vërejtje.

Në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata i ka analizuar deklaratat e palëve ndërgjyqëse, ekspertit dhe i ka administruar të gjitha provat nga lënda si vijon;

- Lexohet dhe administrohet, kartela e kontos, nr. 169, e periudhes 01.01.2010-31.12.2010. Nga kjo provë gjykata sipas deklaratës së paditësit, është bartuar shuma e të hollave në emër të Sava Saviq, nga f. P për pagesën e çmimit kontraktues në lartësi prej 23.500, 00 €.

- Lexohet dhe administrohet, kopja e letënjoftimit, i lëshuar nga organet kompetente të Serbis, për të paditurin, ...tani në adrsë të panjohur, në Serbi.

- Lexohet dhe administrohet, Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtëshme UL-70403052-00673, e lëshuar më dt.23.06.2011, nga DGJKP në Gjilan. Nga kjo provë gjykata konstatoi se ngas.kad.nr.janë të regjistruara në bashkëpronësi për nga 1/2 të pjesës ideale në emër të paditurve - Lexohet dhe administrohet, Çertifikata sipas lëndës nr.1429-2017, e lëshuar më dt.14.02.2017, prej DGJKP, në Gj. Nga kjo provë gjykata konstatoi se ngas.kad.nr. ..ishte e regjistruar në emër të,...

- Lexohet dhe administrohet, Çertifikata sipas lëndës nr.10401-2016, e lëshuar më dt.06.09.2016, prej DGJKP, në Gjilan. Nga kjo provë gjykata konstatoi se ngas.kad.nr. P-70403052-04003-0, eshte e regjistruar në bashkëpronësi për nga 1/2 të pjesës ideale në emër të

- Lexohet dhe administrohet, Çertifikata sipas lëndës nr..., e lëshuar më dt.06.09.2016, prej DGJKP, në Gjilan. Nga kjo provë gjykata konstatoi se ngas.kad.nr. ...eshte e regjistruar në bashkëpronësi për nga 1/2 të pjesës ideale në emër të S.S. nga f. P. K e Gj.

- Lexohet dhe administrohet, Konstatimi me skicën e hartuar nga vendi i ngjarje më dt.19.04.2017, prej ekspertit gjeodet,. Nga kjo provë gjykata konstatoi se pasuria kontestuese, është në pronësi faktike dhe shfrytëzim të paditësit, nga viti 1910 e deri më tani dhe është e mbjellur me bari dhe grur.

Në fjalën përfundimtare, paditësi F.Sh, deklaroi se nga provat e administruara, dëgjimit të ekspertit gjeodet dhe palëve ndërgjyqëse, gjykata e ka konstatuar gjendjen faktike se pasurinë kontestuese paditësi e ka blerë, nga e paditura, paditësi e ka në shfrytëzim si pronar faktik, i pa penguar nga të paditurit, familjarët e tyre dhe meqenikët, e shfrytëzon mbi 15 vite vite, i propozoi gjykatës se nga baza të shitblerjes dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktuese, pagesës së çmimit kontraktues vendos në bazë të Ligjit me aktgjykim meritor dhe ta vërtetoi kërkespadinë e paditësit si të bazuar. Nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, av..., në emër të të paditurve tani në adresë të panjohur, në fjalën përfundimtare deklaroi, në bazë të provave të administruara në seancën e kryesore, dëgjimit të ekspertit gjeodet dhe palëve ndërgjyqëse, është vërtetuar gjendja faktike, andaj i propozoi gjykatës lidhur me zgjidhjen e çështjes kontestuese të vendos sipas Ligjit, me aktgjykim meritor. I kërkoi shpenzimet e procedurës sipas T.A. të Kosovës. në cilësin e pronarit faktik, pasi në bazë të karteles së kontos është konstatuar se është paguar çmimi kontraktues në lartësi prej 23.500,00 € dhe iu ka dërrëzuar paditësit pasuria e paluajtëshme e cekur më lart nga të paditurit e cekur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga të cekurat më lart, gjykata e vërtetoi gjendjen faktike dhe konstatoi se paditësi si pronar faktik e shfrytëzon pasurinë e paluajtëshme, se ka ekzistuar raporti materialo-juridiko, jan përmbushur në tërësi detyrimet kontraktuese mes paditësit dhe të paditurve sipas veprimit juridik kontratës verbale për shitblerjen e pasurisë së paluajtëshme dhe gjykata në bazë të nenit 73 të LMD-ës, e konvalidoi kontratën verbale me shkrim për shitblerjen e pasurisë së paluajtëshme, pasi jan përmbushur në tërësi detyrimet kontraktuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Nga të cekurat më lart, në bazë nenit 73 të LMD-ës / të aplikueshëm/ dhe nenit 143 par.1, të LPK-ës, Gjkata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, sejcila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Gjyqtari
Halil Zahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet në kopje mjaftuara përmes kësaj Gjykate.

